



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Durrës 16.04.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

Në lidhje me procesin e dëmshpërblimit nga permbytja si pasojë e reshjeve të datës 06.01.2026, ju informojmë se nga Titullari i Institucionit është ngritur komisioni i ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuar. I gjithë dokumentacioni do të vlerësohet bazuar në legjislacionin në fuqi dhe lista me përfituesit do të shpallet me Këshill Bashkiak.

Bashkia Durrës, aktualisht është në fazën e pritjes së fondit të kushtëzuar I destinuar për këtë proces. Nisur nga numri I lartë I te prekurve, trajtimi financiar do ti kalojë Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Trajtimi financiar, do të trajtohet me përparësi sipas mundësisë së fondit të kushtëzuar. Aktualisht nuk ka vlerë përfundimtare pasi është në fazë vlerësimi.

Përsa I përket zonave më të dëmtuara janë marrë masa për rehabilitimin e zonave të dëmtuara dhe përmirësimin e sistemit të kullimit të realizuar në përputhje me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligjin nr. 24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe kullimit". Në zbatim të këtyre akteve, janë ndërmarrë ndërhyrje për pastrimin e zonave të prekura dhe përmirësimin e funksionimit të rrjetit të kullimit, veçanërisht në zonat më problematike. Konkretisht, është kryer pastrimi dhe largimi i mbetjeve inerte, si dhe rikthimi në gjendjen e mëparshme të sipërfaqeve të dëmtuara. Paralelisht, janë realizuar ndërhyrje në rrjetin e kullimit, duke përfshirë pastrimin e kanaleve ekzistuese, zhblokimin e pusetave dhe riparimin e segmenteve të amortizuara. Nga ana e SHRUKD sh.a janë pastruar në mënyrë sistematike pusetat e ujërave të ndotura.

Gjithashtu, janë evidentuar pikat kritike, për të cilat janë planifikuar ndërhyrje të mëtejshme me qëllim zgjerimin dhe përmirësimin e kapacitetit të sistemit të kullimit, në funksion të parandalimit të përsëritjes së situatave të ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet përkatëse vijojnë monitorimin e situatës në terren dhe janë në proces të hartimit dhe zbatimit të masave afatgjata për rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës në këto zona.